



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V_469_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_797_05_12

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_797_05_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 20.06.2012.

Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin D. K. (shifra në KEK: DPR - 90031950), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_797_05_12 i datës 24.05.2012.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 20.08.2003 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë bërë pranimin e instalimit elektrik për njehsorin elektrik nr. 14048378 me gjendje TL=33732 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 00007 kWh (tarifa e ulët) si dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse.

Me datë 09.09.2004 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 14048378 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 35451229.

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEK me datë 13.09.2004 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë (korrigjim) në vlerë prej 3,426.65€. Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën (korrigjimin) e bërë nga KEK-u. Departamenti për Konsumatorë në KEK ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit, ku edhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjegjës nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për bartjen e borxhit të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 30.07.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura 7340DPR-90031950-90031 të datës 13.09.2004 në vlerë 3,426.65 €.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 14.06.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr.



ZRRE/DMK_V_797_05_12 të datës 24.05.2012, dhe njëherit ka propozuar që aprohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar dëshmitë e paraqitur nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit e ka paraqitur në procesverbalin e pranimit të njehsorit elektrik.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr. 006519 të datës 20.08.2003 dhe ka vërejtur punëtorët e KEK-ut përveç që kanë bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 14048378 kanë evidentuar edhe gjendjen e njehsorit elektrik si në tarifën e lartë ashtu edhe në tarifën e ulët, e cila gjendje tregon se njehsori elektrik ka pasur kilovat të regjistruar. Në procesverbalin e KEK-ut për ndërrimin e njehsorit elektrik të datës 09.09.2004 është evidentuar ndërrimi i njehsorit elektrik dhe se sipas këtij procesverbali është vërejtur se gjendja e regjistrimit të njehsorit elektrik nr. 14048378 nuk ka ndryshuar në asnjërin prej tarifave, por që njehsori i vendosur nr. 35451229 ka pasur kilovat të shpenzuar, gjë që sipas kësaj vërehet se ai njehsor ka qenë i vendosur edhe më herët. Sipas kësaj del se konsumatori ka pasur që nga fillimi i regjistrimit njehsorin elektrik nr. 35451229 e jo njehsorin elektrik nr. 14048378.

Është analizuar edhe fatura e ngarkuar nga Departamenti i Faturimit i KEK-ut 7340DPR-90031950-90031 të datës 13.09.2004 në vlerë 3,426.65 € për 33,725 kWh, dhe është vërejtur se KEK-u nuk ka prezantuar prova që njehsori elektrik nr. 14048378 është lexuar ndonjë herë apo që ka qenë i vendosur në pikën matëse të konsumatorit si pajisje matëse dhe se nuk përputhet gjendja e regjistruar e njehsorit me atë të proceseve të KEK-ut.

Në ankesën e KEK-ut theksohet se KEK-u është bazuar vetëm në procesverbalin e pranimit të instalimeve të njehsorit elektrik. Sipas kësaj Bordi ka vlerësuar se njehsori elektrik i konsumatorit nr. 14048378 është evidentuar vetëm në vërtetimin apo procesin e regjistrimit të njehsorit elektrik dhe se shifra e konsumatorit DPR – 90031950 ka filluar të faturohet në CCP nga periudha 11/2003 me njehsorin elektrik nr. 35451229 dhe se sipas proceseve vërehet se gjendja e njehsorit elektrik nr. 14048378 nuk ka ndryshuar nga periudha 20.08.2003 e deri te periudha 09.09.2004. Po ashtu KEK-u nuk ka ofruar asnjë dëshmi kush ka bërë kërkesë për regjistrimin e atij njehsori elektrik nr. 14048378. Bordi i ZRRE-së duke i marrë për bazë të gjitha argumentet e theksuara më lart, konstaton se vendimi i DMK-së, është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK-u në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_797_05_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur në dispozitivin e këtij vendimi.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar